

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit "Bashki e Hapur", të realizuar nga ISP dhe të financuar nga Lëviz Albania.

Realizuar nga: Instituti i Studimeve Politike

Adresa: Sheshi "Avni Rustemi", Rruga "Hoxha Tahsim", Pall."Vjero", AP.A17/A,
Tiranë, Shqipëri

Web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Tel: +355-69 22 03 074

Grupi i punës për këtë studim përbëhet nga:

- Prof.As. Dr Afrim Krasniqi – Pedagog, ekspert koordinues
- Dr. Dorina Bërdufi – Eksperte për metodat e kërkimit
- Prof.As. Dr Ervin Karamuco – Ekspert për të drejtat e njeriut
- MA. Rigels Xhemollari – Ekspert për transparencën

**Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave u realizua gjatë periudhës
15.05.2016 - 15.07.2016.**

Tiranë 2016

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive

- » 1.1. Rreth Projektit
- » 1.2. Gjetjet kryesore
- » 1.3. Rekomandime

2. Metodologjia

3. Analiza dhe rezultate

- » 3.1. Kuadri ligjor
- » 3.2. Monitorimi online
- » 3.3. Vlerësimi i bashkive (monitorimi online)
- » 3.4. Monitorimi fizik
- » 3.5. Vlerësimi i bashkive (monitorimi në terren)
- » 3.6. Testimi i bashkive

4. Shtojca

1.Përmbledhje Ekzekutive

» 1.1 Rreth projektit

Ndarja e re territoriale dhe konstituimi përmes zgjedhjeve i 61 bashkive të reja krijuan një realitet dhe marrëdhënie të re midis të zgjedhurve në nivel vendor dhe qytetarëve. Procesi i reformimit u shoqërua me zgjerim të kompetencave të qeverisjes vendore në aspekte të veçanta të funksionimit, sidomos në shërbimet sociale dhe administrative ndaj komunitetit. Struktura e re dhe shtimi i kompetencave sjellin me vete edhe më shumë përgjegjësi dhe nevojë për llogaridhënie, si dhe janë të lidhura direkt me një shumëllojshmëri pritshmërisë dhe interesash qytetare.

Në kuadrin e përgjegjësive të qeverisjes së re lokale koncepti i transparencës dhe i informimit qytetar merr vlerë të vecantë dhe mbetet një prej standardeve kryesore matëse për demokracinë përfaqësuese e funksionale në nivel lokal. E drejta e informimit, si e drejtë kushtetuese, përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët. Transparenca nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e vepërimitarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Aksesit i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit, dhe si i tillë institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, me qëllim që të garantojnë një përdorim sa më efektiv të tij. Gatishmëria në dhënien e informacionit nga institucionet e administratës publike rrit përgjegjshmërinë e tyre në shërbimin ndaj qytetarëve.

Miratimi i ligjit Nr.149/2014 "Për të drejtën e Informimit" ishte një hap i rëndësishëm për garantimin e kësaj të drejte për qytetarët, pa u kushtëzuar në motivimin apo arsyetimin e qëllimit të kërkesës së tyre, dhe nga ana tjetër parashikoi për herë të parë sanksione në rastet e pajustificuara të mohimit të kësaj të drejte dhe refuzimit të informacionit për titullarët e institucioneve dhe koordinatorët për të drejtën e informimit.

Bazuar në realitetet e reja që kanë krijuar reforma territoriale, si dhe institucionet e reja vendore përballë kërkesave të ligjit mbi të drejtën e informimit, Instituti i Studimeve Politike realizoi projektin "Bashki e Hapur". Projekti konsiston në monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit në bashkitë e reja, (Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër), si dhe u mundësua falë mbështetjes dhe financimit nga Lëviz Albania.

ISP nëpërmjet monitorimit online dhe fizik si dhe testim të drejtpërdrejtë sjell një pasqyrë të saktë dhe të plotë mbi nivelin e zbatueshmërisë së ligjit për të drejtën e informimit dhe parimeve të transparencës dhe qeverisjes së hapur në katër bashkitë e përmendura më lart. ISP në përmbushje të misionit të tij për të nxitur organet publike për transparencë dhe qeverisje të hapur nëpërmjet këtij projekti synon nxitjen e zbatimit të ligjit për të Drejtën e Informimit nga administrata e bashkive të reja si kusht kryesor për qeverisje të mirë, të hapur dhe më pranë publikut si dhe inkurajimin e qytetarëve për të përdorur këtë të drejtë.

» 1.2 Gjetjet kryesore

Gjetjet kryesore të bazuara mbi monitorimin online, vëzhgimin në terren në terren dhe testimin e drejtpërdrejtë me anë të kërkesave për informacion të katër bashkive (Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër) sa i takon zbatimit integral të ligjit për të drejtën e informimit janë këto:

Nga monitorimi online i faqeve të bashkive Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë vërejmë:

- » 1. Standardet e larta të ligjit mbi të drejtën e informimit, në tërësi, vijojnë të jenë ende në kontrast me konceptet minimaliste mbi informimin, që dominojnë në administratat vendore, përfshirë në katër nga bashkitë e mëdha në monitorim. Përbushja e detyrimit ligjor për jetësimin praktik dhe në vazhdimësi të çdo elementi të caktuar të ligjit mbi të drejtën e informimit vijon të lexohet e vlerësohet si detyrim formal administrativ, dhe se kultura e hapjes dhe transparencës mbetet ende e brishtë.
- » 2. Administrata, përfshirë drejtuesit e lartë, nuk kanë njohuri të thelluara mbi standardet e vendosura nga ligji mbi të drejtën e informimit dhe përgjegjësitë që burojnë prej tij. Komunikimi zyrtar i ekipit të ISP me një pjesë prej tyre shpesh nxorri në pah mungesën e njohurive specifike të ligjit, si dhe mbivendosje në njohuritë e tyre me akte të tjera ligjore të natyrës administrative.
- » 3. Autoriteti real për jetësimin e ligjit dhe standardeve mbi transparencën dhe informimin nuk gjendet tek sistemi institucional i transparencës, por direkt tek titullarët e institucioneve. Në të gjitha rastet e angazhimit të tyre direkt, problematikat që lidhen me afatet dhe përgjegjësitë ligjore merrnin trajtim cilësor dhe në afat, në shumicën e rasteve të tjera mungojnë këta dy elementë.
- » 4. Jetësimi integral dhe i qëndrueshëm i konceptit të transparencës dhe të informimit kërkon ndryshime të rëndësishme strukturore, të

axhendës dhe të konceptimit nga ana e institucioneve vendore, - një problematikë e cila ende nuk ka gjetur vëmendjen e duhur në strategjitë prioritare të këtyre institucioneve.

» 5. Legjislacioni i ri vendor dhe aktet pasuese, sidomos ato që kanë të bëjnë me strukturën, financimin, organizimin, kompetencat e reja, si dhe procesin e tranzicionit që vjen nga shkrija e njërive vendore të vjetra në 61 bashki të reja, nuk ka marrë në konsideratë standardet që kërkohen nga ligji mbi të drejtën e informimit. Shqetësuese janë sidomos gjendja në njësitë administrative të thella (ish komuna), ku sistemi elektronik dhe koncepti i shërbimeve publike online janë të pamundura ose në faza fillestare, si dhe ku niveli profesional i stafeve përkatëse është larg kërkesave të ligjit.

» 6. Gjithashtu shqetësues është edhe fakti se në të shumtën e rasteve koordinator apo zyrë për informimin nuk janë emëruar ekspertë të trajnuar të fushës, por zytratë të tjerë, pjesë të organikës së vjetër, të cilëve u kalohet/u shtohet edhe një detyrë e re. Pamundësia organike e bashkive për të krijuar stafe të reja profesionale mbetet një sfidë për trajtim në vitin e ardhshëm.

» 7. Në ushtrimin e të drejtës për informim në katër bashkitë, konstatohet edhe fakti se komuniteti, përfshirë grupet e medias, shoqërisë civile dhe grupet e interesit, nuk posedojnë gjithashtu njohuri të thelluara të ligjit dhe praktikave të mira të programit të transparencës dhe të informimit.

» 8. Mungesa e një manuali të referueshëm që bën interpretimin dhe dallimin midis dokumenteve me interes publik dhe dokumenteve të konsideruara jo me interes publik nga bashkitë/institucionet, ka krijuar shpesh interpretime të ndryshme midis ushtrimit të së drejtës për informim dhe leximit të kësaj të drejte nga autoritetet vendore.

» 9. Roli i grupeve monitoruese dhe nxitëse të zbatimit të programit të transparencës dhe të drejtës së informimit mbetet i rëndësishëm dhe i

mirëpritur nga ana e bashkive. Institucionet vendore treguan në tërësi vullnet për korrektim të praktikave dhe për bashkëpunim, duke arritur brenda progres domethënës brenda një kohe të shkurtër.

» 10. Problem tjetër për trajtim mbetet fakti se informacionet e dhëna përmes faqeve online, nuk japin garancinë e nevojshme për saktësi/vertetësi të tyre, gjë që sic rezultoi gjatë monitorimit, mbetet hapësirë keqkuptimi në ushtrimin e funksioneve të vetë institucionit, si dhe në detyrimet sociale të qytetarëve. Shumë më e theksuar është kjo në shërbime, të ndërtuara mbi kosto financiare dhe ku të dhëna të diskutueshme sjellin pasojë financiare për institucionin dhe për qytetarët.

» 11. Koncepti i funksionit të bashkive nuk është plotësuar ende me konceptin e bashkive si njësi e një sistemi të qeverisjes vendore. Krahas bashkisë ekzistojnë edhe një numër institucioneve të varësisë së saj, të cilat gjithashtu duhet të jenë pjesë e procesit të transparencës dhe e sistemit të informimit të njëzuar në bashki. Një pjesë e madhe e këtyre institucioneve nuk kanë faqe interneti, nuk kanë të dhëna, nuk kanë aktivitete transparente publik dhe prezantohen vetëm me adresë / titullar në faqet e bashkive.

» 12. Referuar aspekteve praktike të ligjit dhe të programit të transparencës, grupi monitorues i ISP konstatoi problematika të njëjta për secilën bashki, por edhe problematika të vecuara midis tyre. Midis katër bashkive ka diferencë në standardet e vlerësimit të konceptit të transparencës dhe informimit, si edhe në rëndësinë që i jepet jetësimit të tyre në periudhë afatshkurtër.

» 13. Konkretisht, bashkia Shkodër paraqitet më e plotë në të dhënat e saj publike, kryesisht për meritë të asistencës ndërkombëtare ofruar në këtë bashki. Bashkia Vlorë gjithashtu ka tregues më shumë pozitivë sesa negativë në nivelin e tanishëm të respektimit të ligjit mbi të drejtën e informimit. Bashkia Tiranë kaloi nga një fazë mungese të plotë të programit të transparencës në një standard të referueshëm krahasimi, kurse bashkia Durrës vijon të reflektojë mungesë vëmendje e ndryshimi

në raportet e saj kritike me përgjegjësitë që burojnë nga ligji mbi të drejtën e informimit.

» 14. Në lidhje me përcaktimet e gurmës h, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, rezultoi se regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve tashmë është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Durrës, por tek kjo e fundit ai rezultoi i pa përditësuar me kërkesat e qytetarëve.

Ndërsa Bashkia Vlorë ka publikuar vetëm regjistrin e kërkesave dhe ajo e Tiranës nuk ka publikuar këtë format deri në momentin e monitorimit.

» 15. Mungesë të publikimit të orarit zyrtar të pritjes së ankesave dhe kërkesave nga Bashkia Durrës, mos publikimi i arsimimit dhe kualifikimit të zyrtarëve nga bashkia Vlorë dhe një mungesë e strukturës organizative, pagave, arsimimit dhe funksioneve të ushtruara të zyrtarëve publikë nga Bashkia Tiranë.

» 16. Bashkitë Tiranë dhe Shkodër nuk kanë publikuar në faqet e tyre të internetit kontratat me të tretët për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të përfituara, palët kontraktuese apo shumat e kontraktimit.

» 17. Bashkia Vlorë ka publikuar vetëm faqen ëëë.app.gov.al, ku qytetarët mund të orientohen për prokurimet publike, ndërsa bashkia Durrës nuk përditëson nga viti 2012 regjistrin e prokurimeve publike pavarësisht se e ka të publikuar në faqen e internetit si menu.

» 18. Bashkia Durrës nuk ka publikuar në faqen e saj zyrtare procedurat që qytetarët duhet të ndjekin për të përfutur ndihmën shoqërore. Gjithashtu bashkitë Durrës, Tiranë dhe Vlorë nuk kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare vlerën e subvencioneve për kategoritë e caktuara të ndihmës shoqërore.

Nga vëzhgimi në terren i ambienteve të katër bashkive Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë vërejmë:

- » 1. Bashkitë janë më pak të aksesueshme në terren se online duke shfaqur problematika qoftë edhe me tabelat orientuese.
- » 2. Vëzhguesit e ISP hasën vështirësi për të lënë takim me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë bashkisë Durrës, madje kjo bashki nuk ka të shpallur as orarin e pritjeve për qytetarët pranë zyrave të saj.
- » 3. Bashkia Tiranë nuk ka një zyrë specifike për të drejtën e informimit.
- » 4. Bashkia Vlorë dhe Shkodër e dispononin një zyrë të tillë e cila funksiononte për pritjen e qytetarëve dhe koordinimin e kërkesave për informacion.
- » 5. Bashkia Shkodër ka të afishuar pranë zyrave të saj Programin e Transparencës dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit, si dhe orientimin për zyrat brenda saj.

Nga testimi i katër bashkive nëpërmjet kërkesave për informacion rezulton se

- » 1. Nga tetë kërkesat e dërguara me iniciativën e ISP, pesë prej tyre kanë marrë përgjigje të plotë, një kërkesë ka marrë përgjigje të paplotë dhe dy kërkesa nuk kanë marrë përgjigje.
- » 2. Nga gjashtë përgjigjet e kërkesave bashkitë i janë përgjigjur pesë prej tyre brenda afatit ligjor dhe një kërkesë dy ditë pas afatit ligjor dhe pas ankimimit të ISP pranë KDIMP.

- » 3. Bashkitë Shkodër dhe Vlorë i janë përgjigjur në afat kërkesave të iniciuara nga ISP, bashkia Tiranë i është përgjigjur një kërkesë në afat dhe tjetrës pas kalimit të afatit ligjor, ndërsa bashkia Durrës ka refuzuar ti përgjigjet dy kërkesave që qytetarët i kanë nisur bashkisë.
- » 4. Pesë nga kërkesat që morën përgjigje, informacionin e disponoi vetë institucioni të cilit iu dërgua kërkesa, ndërsa një përgjigje iu dërgua institucionit që e dispononte informacionin nga bashkia Vlorë, bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- » 5. Sa i takon njoftimit paraprak brenda 48 orëve të kërkesit për marrjen, regjistrimin e kërkesës apo mos disponimin e informacionit, asnjëra nga katër bashkitë nuk e ka përmbushur këtë detyrim ndaj qytetarëve.

» 1.3 Rekomandimet

- Bashkitë kanë nevojë të veprojnë si entitet përfaqësues për të gjithë territorin dhe strukturat e varësisë, duke ofruar të gjithë paketën e shërbimeve ndaj publikut, sic janë të përcaktuara në programin e transparencës dhe ligjin mbi të drejtën e informimit.
- Qeverisja vendore, përfshirë katër bashkitë e monitoruara, kanë nevojë për asistencë dhe investime infrastrukturë dhe në personel, për të jetuar detyrimet e tyre në kuadër të transparencës dhe informimit publik.
- Faqet e internetit të bashkive duhet të kenë të publikuar në ballinën e faqeszyrtare të internetit Programin e Transparencës për t'i orientuar qytetarët në aksesimin e plotë dhe gjetjen lehtësisht të informacionit të kërkuar online pa pasur nevojë të iniciojnë kërkesë apo të paraqiten fizikisht pranë bashkisë.
- Bashkitë duhet ta zgjerojnë kapacitetin e ofrimit të shërbimeve infor-

muese për qytetarët, sidomos në shërbime me interes të përgjithshëm, sic janë cilësia e shkollave/kopshteve/cerdheve, publikimi i projekteve dhe axhendës së detajuar vjetore, zgjerimi të përfaqësimit qytetar në aktivitetin e njërive administrative dhe këshillave bashkiake, si dhe pa-surimin e mekanizmave/mjeteve me të cilat qytetarët mund të kontaktojnë dhe komunikojnë me zyrtarët përgjegjës.

- Bashkitë në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit duhet të krijojnë standarde të detajuara të akteve administrative dhe objektit të drejtës për informim, me synim, njësimin e praktikave dhe zgjerimin e bazës – objekt për të drejtën e informimit, si dhe reduktimin e rasteve të refuzimit burokratik të të dhënave.

- Bashkitë duhet të informojnë qytetarët për të drejtat e tyre, përmes një zëri të posaçëm në buxhetin lokal, si dhe të krijojnë mekanizma nxitjeve (adresarin e letrave, adresarin e komunikimeve online, komunikimeve telefonike, platforma online etj), për të zgjeruar numrin e qytetarëve të informuar dhe për pasojë, për të rritur cilësinë e shërbimeve ndaj tyre.

- Bashkitë duhet të respektojnë procedurat dhe afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve dhe adresimin e kërkesave/ankesave, pasi shpesh nuk ka bashkërendim të punës mes strukturave të brendshme dhe vihet re mangësi në njohjen dhe në zbatimin e ligjit, duke ndikuar kjo në cilësinë dhe kohën e dhënies së informacionit për qytetarët.

- Bashkitë duhet të publikojnë online aktet ligjore, vendimet bashkiake, rregulloret e funksionimit të organeve vendore dhe planet e veprimit një vjeçare për t'i dhënë mundësi qytetarëve që të veprojnë sipas rregullave në fuqi (rasti i rregullave të reja për të marrë leje ndërtimi).

- Bashkitë duhet të pajisen urgjentisht me zyra të posaçme për të drejtën e informimit dhe koordinatorët për të drejtën e informimit duhet të angazhohen për të orientuar dhe nxitur qytetarët në inicimin e kërkesave për informacion. Gjithashtu në këndet e informimit duhet të shpallen regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve me datat përkatëse.

- Bashkitë duhet të publikojnë online kontratat me të tretët në momen-

tin e nënshkrimit të tyre për punët publike, detyrim i parashikuar për tu publikuar në Programin e Transparencës në mënyrë që të parandalohet korrupsioni dhe ryshfeti i mundshëm kundrejt zyrtarëve të bashkisë dhe shoqëria civile apo qytetarët të monitorojnë punimet.

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të ndër marrë masat administrative me gjobë në rastet e mos publikimit të plotë të Programeve të Transparencës ndaj titullarëve të autoriteteve publike vendore dhe nga Koordinatorëve për të drejtën e informimit në rastet e ankesave të qytetarëve.

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nisma serioze si Leviz Albania, përmes akordimit cdo vit të çmimit kombëtar mbi cilësinë e informimit nga bashkitë, si dhe renditjes së 61 bashkive për nga standardi i zbatimit të ligjit, mund të luajnë rol me rëndësi promovues, ndërgjegjësues dhe nxitës në konkurrimin dhe imazhin e bashkive.

- Organizatrat e shoqërisë civile dhe media duhet të përdorin masivisht ligjin për të drejtën e informimit në marrëdhënien e tyre me bashkinë në funksion të mbrojtjes së interesave të grupeve që përfaqësojnë dhe të informojnë vazhdueshëm qytetarët mbi procedurat e marrjes së informacionit pranë autoriteteve publike duke përdorur ligjin për të drejtën e informimit.

2. Metodologjia

Metodologjia e projektit synon një monitorim të pavarur, objektiv dhe të paanshëm të zbatimit të ligjit të informimit publik. Qasja e aplikuar është përgjithësisht kombinim i shqyrtimit të të dhënave primare dhe sekondare. Vrojtimi në terren dhe online nëpërmjet fishave të raportimit përfshin institucionet, aktorët e përfshirë, njoftimet zyrtare, faqet e internetit, regjistrin e kërkesave, Programin e Transparencës dhe elementet e tjerë të ligjit. Hartimi i mjeteve, materialeve të regjistrimit, të printuara, interpretimi i të dhënave dhe realizimi do të kryhen përkatësisht nga ekspertët, koordinatorët dhe operatorët e ISP.

Pas monitorimit procesi vazhdon me analizimi dhe publikimi e të dhënave dhe gjetjeve të monitorimit, mbi bazën e të cilave do të nxirren edhe rekomandimet drejtuar titullarëve të bashkive të reja dhe Ministrisë për Çështjet Vendore.

Njëkohësisht do të publikohen edhe rezultatet e testimit të drejtpërdrejtë të Bashkive dhe mediatizimi i 3 ankesave kryesorë të ngritura nga qytetarët tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale më qëllim kthimin e tyre në modele pozitive dhe rrugëzgjdhje për të gjithë qytetarët.

Vlerësimi i bashkive sa i takon nivelit të transparencës bazuar në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Renditja e indikatorëve matës monitorues është bërë bazuar në kompetencat që ligji i ngarkon titullarëve të bashkive, koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe bazuar në detyrimet ligjore të autoritetit publik ndaj qytetarëve. Në fillim kemi renditur ato që kanë të bëjnë me informacionin që duhet bërë publik pa kërkesë dhe emërimin e koordinatorit dhe më pas procedimin me kërkesat për informacion dhe regjistrimin e tyre, më pas sipas rëndësisë publike dhe nevojës për më shumë transparencë vijnë elementët e tjerë të përcaktuara në ligjin për të drejtën e informimit. Mbi këto indikatorë është ngritur edhe sistemi i pikëzimit për vlerësimin e katër bashkive. Indikatorët matës janë kuotuar sipas rëndësisë që paraqesin në ligjin për të drejtën e informimit dhe në kontributin që ato kanë në funksion të rritjes së aksesit të publikut në informacion. ISP ka kuotuar me pikë indikatorët si më poshtë:

- 4 pikë- informacioni që duhet bërë publik pa kërkesë
- 3 pikë- emri i koordinatorit, adresa, etj., regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- 2 pikë- procedurat e kërkesave për informacion dhe regjistrimi i tyre
- 1 pikë- elemente të tjerë të përcaktuar në ligjin e të drejtës së informimit

3. Analiza dhe Rezultate

» 3.1 Kuadri ligjor

a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 23 parashikon se e drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Po ashtu ky nen parashikon të drejtën e individit të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Po ashtu neni 48 i Kushtetutës parashikon se kushdo, vetë ose me bashkë me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

b. Kodi i Procedurave Administrative

Neni 13 i Kodit të Procedurave Administrative, aktual, parashikon se Organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bashkëpunim të ngushtë me personat privatë duke u siguruar personave privatë informacionin dhe sqarimet e nevojshme. Po ashtu neni 20 me titull "E drejta për t'u informuar" parashikon se të gjithë pjesëmarrësit në një procedure administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

c. Ligji Nr. 139/17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Neni 15 i ligjit përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

ç. Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Mbi bazën e Kushtetutës, Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", rregullon në mënyrë të hollësishme të drejtën e informimit dhe realizimin e saj në praktikë, duke përcaktuar edhe detyrimet që burojnë nga ligji për organet publike në nivel qendror apo vendor, si dhe afatet e procedurat që duhet të respektohen në realizimin e kësaj të drejte. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Informacioni publik

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Nga ana e tij, Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Kërkesa për informacion

Kërkesa për informacion bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuetit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Kërkesa për informacion duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Në qoftë se kërkesa për informacion **nuk e përcakton formatin** në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Afatet

Autoriteti publik trajton kërkesën për informacion, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, **por jo më vonë se 10 ditë pune** nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim. Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.

Programi i Transparencës

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Në përgatitjen e projekt-programit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Regjistri i kërkesave

Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Penalitetet

Mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, konsiderohet kundravajtje administrative dhe dënohet me **50 000** deri në **100 000** lekë; po ashtu mos-rishikimi i programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me **50000** deri në **100 000** lekë;

Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik, vendor në këtë rast, cakton një prej nëpunësve si **koordinator për të drejtën e informimit**.

Ankimi administrativ

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditësh. Kur e sheh të përshtatshme Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. Komisioneri kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.

Ankimi në gjykatë

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

» 3.2 Monitorim i faqes së internetit për 4 Bashkitë

Monitorim në dy faza: 15/5/2016 & 10/6/2016

A.Të dhënat sipas grupeve tematike për katër bashkitë:
Faqa e internetit dhe Koordinatori për të drejtën e Informimit

Katër bashkitë e përzgjedhura përbushin detyrimin e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" për tu pajisur me faqe interneti. Gjithashtu bazuar në kërkesat e ligjit në lidhje me përcaktimet e germës ç, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion me të dhënat për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit, *nga monitorimi rezulton se një informacion i tillë është i paraqitur në mënyrë të plotë sipas përcaktimeve ligjore në katër bashkitë e monitoruara.*

1.Faqa e internetit

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Faqe zyrtare interneti	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Totali/grup	1	1	1	1				

2.Koordinatori për të drejtën e informimit

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Emri i Koordinatorit	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
E-mail i koordinatorit	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Kontakti telefonik	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Totali/grup	3	3	3	3				

Fig. 1 Faqet Zyrtare të katër Bashkive "Koordinatorët për të Drejtën e Informimit"





Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave/Përgjigjeve

Në lidhje me detyrimin e parashikuar nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 4/1që detyron autoritetet publike për të publikuar online Programin e Transparencës në kohën e monitorimit e plotësojnë vetëm bashkia Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Ndërsa bashkia Tiranë nuk e ka të publikuar PT në dy vëzhgimet e njëpasnjëshme të ISP. Me ndarjen e re administrative dhe rritjen e kompetencave dhe përgjegjësi-ve, por edhe të popullsisë nën administrim mungesa e PT në faqen zyrtare të bashkisë sjell konfuzion, mungesë informacioni dhe koordinimi për qytetarët.

3. Publikimi i programit të transparencës

Indikator	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Programi i Transparencës		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Totali/grup	0	1	1	1				

Në lidhje me përcaktimet e germës h, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji, nga monitorimi rezulton se regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve tashmë është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Durrës, por tek kjo e fundit ai rezulton i pa

papërditësuar me kërkesat e qytetarëve. Ndërsa Bashkia Vlorë ka publikuar vetëm regjistrin e kërkesave dhe ajo e Tiranës nuk ka publikuar këtë format deri në momentin e monitorimit.

Publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve është një detyrim ligjor, tregon nivelin e transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe një standard i cilësisë së ofrimit të shërbimit ndaj qytetarit. Gjithashtu mos-krijimi, mos-mbajtja, mospublikimi apo mos-përditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.

Përgjegjësia administrative për mospublikimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve bie mbi Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë autoritetit publik.

Përgjegjësia administrative për mospublikimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve bie mbi Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë autoritetit publik.

4. Transparenca në shërbim ndaj publikut

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Regjistri i kërkesave		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Regjistri i përgjigjeve		+		+	2	2	Durrës/ Shkodër	Tiranë/ Vlorë
Shërbimet		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Sistem dokumentacioni		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Totali/grup	0	4	3	4				

Struktura Organizative, aspekti ligjor dhe vendimet bashkiake

Neni 7 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" sanksionon se të gjitha autoritetet publike, në përputhje me programin e transparencës së miratuar duhet të venë

në dispozicion të publikut në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të paraqitura në tabelë të cilat merren pa pasur nevojën e kërkesës për informacion.

Nga monitorimi online vihet re mungesa e publikimit të orarit zyrtar të pritjes së ankesave dhe kërkesave nga bashkia Durrës, mos publikimi i arsimimit dhe kualifikimit të zyrtarëve nga bashkia Vlorë dhe një mungesë e strukturës organizative, paga-ve, arsimimit dhe funksioneve të ushtruara të zyrtarëve publikë nga bashkia Tiranë.

5.Struktura organizative

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Adresa e zyrave	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Orari i pritjes së kërkesave/ ankesave	+	+	+		3	1	Tiranë/ Vlorë/ Shkodër	Durrës
Struktura organizative		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Funksione dhe detyra		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Arsimin dhe kualifikim		+		+	2	2	Durrës/ Shkodër	Tiranë/ Vlorë
Pagat		+	+	+	3	1	Durrës/ Vlorë/ Shkodër	Tiranë
Totali/grup	2	6	5	5				

Neni 7 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" parashikon për autoritetet publike gjithashtu edhe publikimin pa kërkesë të konventave, ligjeve dhe akteve që rregullojnë procedurat e pushtetit vendor dhe marrëdhënien e bashkisë me qytetarin.

Në momentin e monitorimit të katër bashkitë e përzgjedhura rezultojnë se i publikojnë rregullisht vendimet e këshillave bashkiake, si akte të nxjerra nga autoritetet lokale por bashkia Durrës dhe Vlorë nuk ka publikuar konventat që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pushtetin lokal dhe një pjesë të ligjeve dhe akteve në fuqi.


6.Aspekti ligjor

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Konventa	+	+			2	2	Tiranë/ Shkodër	Vlorë/ Durrës
Ligje dhe akte	+	+	+		3	1	Tiranë/ Vlorë/ Shkodër	Durrës
Rregullore	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Procedura	+	+		+	3	1	Tiranë/ Durrës/ Shkodër	Vlorë
Monitorim dhe kontroll		+	+		2	2	Tiranë/ Shkodër	Tiranë/ Durrës
Totali/grup	4	5	3	2				

7.Vendimet bashkiake

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Vendimet bashkiake	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Totali/grup	1	1	1	1	4			

Fig. 2 Faqet Zyrtare të katër Bashkive "Struktura organizative, pagat dhe funksionet"



Financat dhe shërbimet sociale

Zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit dhe niveli i transparencës financiare që ky ligj parashikon për autoritetet publike sa i përket shpenzimeve, prokurimeve dhe kontratave të lidhura me privatët nxjerr në pah edhe një nga qëllimet kryesore të ligjvënësit për rritjen e llogaridhënies nga ana e qytetarëve dhe parandalimin e korrupsionit nga ana e bashkive. Sa më pak transparente dhe e mbyllur të jetë bashkia, aq më shumë do të jetë e ekspozuar ndaj korrupsionit. Për të zgjidhur këtë dilemë për qytetarët, sipas nenit 7 të ligjit, procedurat dhe kontratat e prokurimeve duhet të jenë të publikuara në kategorinë e informacionit pa kërkesë në faqen zyrtare të bashkisë.

Nga monitorimi i ISP rezulton se bashkitë Tiranë dhe Shkodër nuk kanë publikuar në faqet e tyre të internetit kontratat me të tretët për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të përfituara, palët kontraktuese apo shumat e kontraktimit. Ndërkohë që bashkia Vlorë ka publikuar vetëm faqen ëëë.app.gov.al, ku qytetarët mund të orientoohen për prokurimet publike, ndërsa bashkia Durrës nuk përditëson nga viti 2012 regjistrin e prokurimeve publike pavarësisht se e ka të publikuar në faqen e internetit si menu.

8.Financat

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Buxhet dhe plan shpenzimesh	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Prokurime			+	+	2	2	Durrës/ Vlorë/	Tiranë/ Shkodër
Kontratat të lidhura				+	1	3	Durrës	Tiranë/ Vlorë/ Shkodër
Totali/grup	1	1	2	3				


Marrëdhënia e bashkisë me qytetarin ka në thelb shërbimin që ky autoritet i ofron publikut. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" parashikon se në kategoritë e informacioneve të publikuara pa kërkesë duhet të bëjë pjesë edhe informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit.

Nga monitorimi online rezulton se bashkia Durrës nuk ka publikuar në faqen e saj zyrtare procedurat që qytetarët duhet të ndjekin për të përfituar ndihmën shoqërore. Gjithashtu bashkitë Durrës, Tiranë dhe Vlorë nuk kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare vlerën e subvencioneve për kategoritë e caktuara të ndihmës shoqërore.

9.Shërbimet Sociale

Indikatori	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës	Numri i Bashkive që e plotësojnë këtë indikator	Numri i Bashkive që nuk e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që e plotësojnë këtë indikator	Bashkitë që nuk e plotësojnë këtë indikator
Kategoritë e ndihmës shoqërore	+	+	+	+	4	0	Tiranë/ Durrës/ Vlorë/ Shkodër	-
Subvencionet për ndihmë shoqërore		+			1	3	Shkodër	Tiranë/ Durrës/ Vlorë
Procedurat për ndihmë shoqërore	+	+	+		3	1	Tiranë/ Vlorë/ Shkodër	Durrës
Totali/grup	2	3	2	1				

Fig. 2 Faqet Zyrtare të katër Bashkive "Financat dhe shërbimet sociale"



Përgjegjësia administrative për mosvënien në zbatim të programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë. Sipas nenit 19, pikat 1 ligjit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore - administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat "b", "c", "ç" dhe "h", të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.

» 3.3 Vlerësimi me pikë gjatë monitorimit online për katër Bashkitë

Tabela e mëposhtme parqet vlerësimin e katër bashkive të monitoruara nëpërmjet faqeve të tyre zyrtare online në dy faza 15/5/2016 dhe 10/6/2016 sa i takon plotësimin të elementëve që parashikon ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Bashkia Shkodër ka arritur të grumbullojë 51 pikë në total, e ndjekur nga bashkia Durrës me 48 pikë dhe Vlorë me 45 pikë. Bashkia Tiranë bazuar në pikëzimin sipas metodologjisë së ISP, renditet e fundit me 24 pikë.

Sqarim për pikëzimin: Indikatorët e mëposhtëm matës janë kuotuar sipas rëndësisë që paraqesin në ligjin për të drejtën e informimit dhe në kontributin që ato kanë në funksion të rritjes së aksesit të publikut në informacion. ISP ka kuotuar me pikë indikatorët si më poshtë:

- 4 pikë-informacioni që duhet bërë publik pa kërkesë
- 3 pikë- emri i koordinatorit, adresa, etj., regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- 2 pikë- procedurat e kërkesave për informacion dhe regjistrimi i tyre
- 1 pikë- elemente të tjerë të përcaktuar në ligjin e të drejtës së in formimit

Nr.	Pikëzim/indikator	Indikator	Pikëzimi	Pikëzimi	Pikëzimi	Pikëzimi	Pikë/indikator në 4 Bashkitë	Pikë max/indikator në 4 Bashkitë	⁴ pikë të marra-pikë maksimale në 4 Bashkitë
			Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës			
1	4	Faqe zyrtare interneti	4	4	4	4	16	16	0
2	4	Programi i Transparencës	0	4	4	4	12	16	-4
3	3	Emri i Koordinatorit	3	3	3	3	12	12	0
4	3	E-mail i koordinatorit	3	3	3	3	12	12	0
5	3	Kontakti telefonik	3	3	3	3	12	12	0
6	3	Regjistri i kërkesave	0	3	3	3	9	12	-3
7	3	Regjistri i përgjigjeve	0	3	0	3	6	12	-6
8	2	Vendimet bashkiake	2	2	2	2	8	8	0
9	2	Struktura organizative	0	2	2	2	6	8	-2
10	2	Funksione dhe detyra	0	2	2	2	6	8	-2
11	2	Pagat	0	2	2	2	6	8	-2
12	2	Arsimin dhe kualifikim	0	2	0	2	4	8	-4
13	2	Buxhet dhe plan shpenzimesh	2	2	2	2	8	8	0
14	2	Prokurime	0	0	2	2	4	8	-4
15	2	Kontratat të lidhura	0	0	0	2	2	8	-6

16	2	Orari i pritjes së kërkesave/ankesave	2	2	2	0	6	8	-2
17	2	Adresa e zyrave	2	2	2	2	8	8	0
18	2	Shërbimet	0	2	2	2	6	8	-2
19	2	Sistem dokumentacioni	0	2	2	2	6	8	-2
20	1	Konventa	1	1	0	0	2	4	-2
21	1	Ligje dhe akte	1	1	1	0	3	4	-1
22	1	Rregullore	1	1	1	1	4	4	0
23	1	Procedura	1	1	0	1	3	4	-1
24	1	Monitorim dhe kontroll	0	1	1	0	2	4	-2
25	1	Kategoritë e ndihmës shoqërore	1	1	1	1	4	4	0
26	1	Subvencionet për ndihmë shoqërore	0	1	0	0	1	4	-3
27	1	Procedurat për ndihmë shoqërore	1	1	1	0	3	4	-1
Total (max. 55 pikë/bashki)			27	51	45	48	171	220	-49
^ pikë të fituara-pikë maksimale/bashki			-28	-4	-10	-7	-49		
Diferenca me Bashkinë e Tiranës			24	18	21				-1

» 3.4 Monitorimi me dy faza në terren (zyrat e Bashkisë: Tiranë, Shkodër, Vlorë, Durrës)

Instituti i Studimeve Politike paralelisht me monitorimin online, monitoroi me dy faza dt. 15 Maj dhe 30 Maj 2016 zyrat e bashkive në terren.

Nga monitorimi në terren rezultoi se bashkitë janë më pak të aksesueshme se online duke shfaqur problematika qoftë edhe me orientimin. Vëzhguesit e ISP hasën vështirësi për të lënë takim me koordinatoren e Bashkisë Durrës, madje kjo bashki nuk ka të shpallur as orarin e pritjeve për qytetarët pranë zyrave të saj. Ndërsa Bashkia Tiranë nuk ka një zyrë specifike për të drejtën e informimit. Bashkia Vlorë dhe Shkodër dispononin një zyrë të tillë e cila funksiononte për pritjen e qytetarëve dhe koordinimin e kërkesave për informacion. Vetëm Bashkia Shkodër ka të afishuar pranë zyrave të saj Programin e Transparencës dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit, si dhe orientimin për zyrat brenda saj.

Pamje nga zyra "one stop" për informimin publik Bashkia Shkodër.



Pamje nga këndi i njoftimeve, Bashkia Vlorë.



Pamje e publikimit të orarit të pritjeve, Bashkia Tiranë.



» 3.5 Vlerësimi me pikë gjatë monitorimit në terren për katër Bashkitë

Tabela e mëposhtme paraqet vlerësimin e katër bashkive të monitoruara gjatë vëzhgimit në terren në dy faza. **Për shkak të mungesës dhe vështirësisë së aksesimit nga qytetarët pranë bashkisë Durrës, ISP e ka vlerësuar me 0 pikë këtë bashki. Bashkia**

Vlorë e vlerësuar me 5 pikë krijon akses për qytetarët, ka orar pritjesh por nuk gjejmë të shpallur Programin e Transparencës, emrin dhe kontaktin e koordinatorit dhe regjistrat e kërkesave për informacion dhe përgjigjeve. Bashkia Shkodër është vlerësuar me 19 pikë pasi në zyrat e saj në terren gjejmë të shpallura disa nga elementët e ligjit për të drejtën e informimit, ndërsa bashkia Tiranë është vlerësuar me 8 pikë.

Sqarim për pikëzimin: Indikatorët e mëposhtëm matës janë kuotuar sipas rëndësisë që paraqesin në ligjin për të drejtën e informimit dhe në kontributin që ato kanë në funksion të rritjes së aksesit të publikut në informacion. ISP ka kuotuar me pikë indikatorët si më poshtë:

- 4 pikë-informacioni që duhet bërë publik pa kërkesë
- 3 pikë- emri i koordinatorit, adresa, etj., regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- 2 pikë- procedurat e kërkesave për informacion dhe regjistrimi i tyre
- 1 pikë- elemente të tjerë të përcaktuar në ligjin e të drejtës së informimit

Nr.	Pikëzim/indikator	Indikator	Pikëzimi	Pikëzimi	Pikëzimi	Pikëzimi	Pikë/indikator në 4 Bashkitë	Pikë max/indikator në 4 Bashkitë	^Δ pikë të marra-pikë maksimale në 4 Bashkitë
			Tiranë	Shkodër	Vlorë	Durrës			
1	4	Programi i Transparencës	0	4	0	0	4	16	-12
2	3	Emri i Koordinatorit	0	3	0	0	3	12	-9
3	3	E-mail i koordinatorit	0	0	0	0	0	12	-12
4	3	Kontakti telefonik	0	0	0	0	0	12	-12
5	3	Regjistri i kërkesave	3	3	0	0	6	12	-6
6	3	Regjistri i përgjigjeve	3	3	0	0	6	12	-6
7	2	Struktura organizative	0	0	0	0	0	8	-8
8	2	Orari i pritjes së kërkesave/ankesave	2	2	2	0	6	8	-2
9	2	Adresa e zyrave	0	2	0	0	2	8	-6
10	2	Shërbimet	0	2	2	0	4	8	-4
11	1	Procedura	0	0	0	0	0	4	-4

12	1	Kategoritë e ndihmës shoqërore	0	0	1	0	1	4	-3
Total			8	19	5	0	32	116	-84
⁴ pikë të fituara-pikë maksimale/bashki (max. 29 pikë/bashki)			-21	-10	-24	-29	-84		
Diferenca me Bashkinë e Tiranës				11	-3	-8	0		

» 3.6 Testimi i katër bashkive nëpërmjet kërkesave për informacion

Instituti i Studimeve Politike krahas monitorimit në terren dhe online përdori edhe testimin e katër bashkive me kërkesa për informacion si mjet për të matur zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit nga ana e bashkive dhe disponibilitetin e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve. ISP dërgoi gjithsej tetë kërkesa për informacion, nga dy kërkesa për secilën bashki dhe grumbulloi informacionin e marrjes ose jot ë përgjigjeve nga ana e bashkive. Sa i takon tipit të kërkesave që u përdorën, ISP bëri një renditje dhe klasifikim sipas grupeve të interesit dhe natyrës së çështjeve të cilat e lidhin qytetarin me bashkinë.

Më poshtë gjeni të renditur tipet e përmbajtjes së kërkesave për informacion që u dërguan në katër bashkitë e monitoruara dhe grupet e interesit që përfaqësonin kërkuesit e informacionit të cilave u kemi vendosur kodin përkatës për lehtësi në pasqyrimin e të dhënave:

* Tipi i kërkesës

Kodi Përshkrimi

- 1 Struktura, organizimi i autoritetit publik, arsimimi dhe kualifikimi i nëpunësve të tij
- 2 Lista e kontratave të lidhura me të tretet dhe procedurave koncesionare
- 3 Të dhëna mbi taksat, gjobat dhe tarifat vendore bazuar në shërbimet që ofron bashkia
- 4 Vendimet e këshillit bashkiak
- 5 Politikat publike dhe shërbimet sociale (ndihma sociale, karta e studentit)
- 6 Të dhëna mbi pronësinë dhe planifikimin e territorit

* Grupi i interesit

Kodi	Përshkrimi
1	Biznes
2	Të pastrehë dhe romë
3	Persona me aftësi të kufizuar
4	Pronarë
5	Banorë/qytetarë
6	Fermer
7	Student
8	Aktivistë të shoqërisë civile

Të dhënat e përfituara nga testimi i bashkive Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Durrës

Total 8 kërkesa: 2 kërkesa për çdo Bashki.

A.Sipas tipit të kërkesës:

- 4 kërkesa janë të tipit "Politikat publike dhe shërbimet sociale (ndihma sociale, karta e studentit)" - 2 në Durrës, Tiranë dhe Shkodër
- 3 kërkesa të tipit "Struktura, organizimi i autoritetit publik, arsimimi dhe kualifikimi i nëpunësve të tij" - Shkodër, Tiranë dhe Vlorë
- 1 kërkesë e tipit "Të dhëna mbi pronësinë dhe planifikimin e territorit"- Vlorë

Tipi i kërkesës	Përsëritja	Bashkia
Politikat publike dhe shërbimet sociale (ndihma sociale, karta e studentit)	4	Durrës, Durrës, Tiranë, Shkodër
Struktura, organizimi i autoritetit publik, arsimimin dhe kualifikimin e nëpunësve të tij	3	Shkodër, Tiranë dhe Vlorë
Të dhëna mbi pronësinë dhe planifikimin e territorit	1	Vlorë
Total	8	

B.Sipas grupit të interesit që bën kërkesë:

- 3 kërkesa të grupit "Të pastrehë dhe romë"- 2 në Durrës dhe Shkodër
- 2 kërkesa të grupit "Banorë/qytetarë"- 2 në Vlorë
- 2 kërkesa të grupit "Aktivistë të shoqërisë civile"- Shkodër dhe Tiranë
- 1 kërkesë të grupit "Student"- Tiranë

Grupi i interesit	Përsëritja	Bashkia
Të pastrehë dhe romë	3	Durrës, Durrës, Shkodër
Aktivistë të shoqërisë civile	2	Shkodër, Tiranë
Banorë/qytetarë	2	Vlorë, Vlorë
Total	8	

C.Të dhëna të përgjithshme mbi Kërkesën për informim pranë Bashkive:**Plotësimi i detyrimeve ligjore të institucionit ndaj kërkuarit:**

- Njoftohem për marrjen e kërkesës- 0 pozitive
- Njoftohem për regjistrimin e kërkesës- 0 pozitive
- Përgjigje brenda 48 orëve nëse kërkesa nuk dërgohet në autoritetin kompetent 0 pozitive

Të dhëna të përgjithshme mbi Kërkesën për informim pranë Bashkive	Bashkitë që e kanë plotësuar	Bashkia që nuk e ka plotësuar	Tipi i kërkesës
Njoftohem për marrjen e kërkesës	0	Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë	1, 5, 6
Njoftohem për regjistrimin e kërkesës	0	Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë	1, 5, 6
Përgjigje brenda 48 orëve nëse kërkesa nuk dërgohet në autoritetin kompetent	0	Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë	1, 5, 6

D.Të dhëna specifike mbi Kërkesën për informim pranë Bashkive:

» **Marrja e përgjigjes:** 5 nga 8 kërkesa kanë marrë përgjigje të plotë, përkatësisht 2 kërkesat në Shkodër, 1 në Tiranë dhe 2 në Vlorë.

» **Përgjigje e plotë** -5 kërkesa: Tiranë, Vlorë, Shkodër

» **Koha e marrjes së përgjigjes:**

• **Disponuar nga institucioni:**

1. Bashkia Shkodër- 5 ditë marrja e përgjigjes (brenda afatit ligjor)
2. Bashkia Vlorë - 10 ditë marrja e përgjigjes (brenda afatit ligjor)
3. Bashkia Tiranë- 12 ditë marrja e përgjigjes (jashtë afatit ligjor)

• **Disponuar nga një institucion i ndërmjetëm:**

1. Bashkia Vlorë - 6 ditë (me institucion të ndërmjetëm Drejtorinë e Kulturës së qytetit)

***Format e marrjes së përgjigjeve** janë të ndryshme: rrugë elektronike, telefonuar nga koordinatori dhe, njoftuar nga koordinatori dhe e ka marrë informacionin pranë zyrave të bashkisë.

» Përgjigje jo e plotë 1 kërkesë: Tiranë

» Mos-marrje përgjigje- 2 kërkesë: 2 Durrës

Tabelë përmbledhëse e të dhënave mbi kërkesat për informacion drejtuar katër bashkive

Të dhëna specifike mbi Kërkesën për informim pranë Bashkive	Nr I kërkesave drejtuar Bashkive	Tipi i kërkesës	Bashkitë
Përgjigje e plotë	5	5, 1, 1, 1, 6	Shkodër, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Vlorë
Përgjigje jo e plotë	1	5	Tiranë
Informacioni i disponuar nga vetë institucioni i kërkesës	5	5,5, 1, 1, 1	Shkodër, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Tiranë
Informacioni i disponuar nga një institucion tjetër	1	6	Vlorë
Nuk kam marr përgjigje	2	5, 5	Durrës, Durrës

Analizë e rezultateve të testimit të bashkive

Nga testimi nëpërmjet kërkesave për informacion rezultoi se nga tetë kërkesat e dërguara me iniciativën e ISP, pesë prej tyre kanë marrë përgjigje të plotë, një kërkesë ka marrë përgjigje të paplotë dhe dy kërkesa nuk kanë marrë përgjigje. Gjithashtu nga gjashtë përgjigjet e kërkesave bashkitë i janë përgjigjur pesë prej tyre brenda afatit ligjor dhe një kërkesë dy ditë pas afatit ligjor dhe pas ankimimit të ISP pranë KDIMP.

Bashkitë Shkodër dhe Vlorë i janë përgjigjur në afat kërkesave të iniciuara nga ISP, bashkia Tiranë i është përgjigjur një kërkesë në afat dhe tjetrës pas kalimit të afatit ligjor, ndërsa bashkia Durrës ka refuzuar ti përgjigjet dy kërkesave që qytetarët i kanë nisur



bashkisë.

Pesë nga kërkesat që morën përgjigje, informacionin e disponoi vetë institucioni të cilit iu dërgua kërkesa, ndërsa një përgjigje iu dërgua institucionit që e dispononte informacionin nga bashkia Vlorë, bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarësin". Ndërsa sa i takon njoftimit paraprak Brenda 48 orëve të kërkuarësit për marrjen, regjistrimin e kërkesës apo mos disponimin e informacionit asnjëra nga katër bashkitë nuk e ka përmbushur këtë detyrim ndaj qytetarëve.

4. Shtojca

Foto nga aktivitetet



Kodi i Transparencës

KODI I TRANSPARENCËS

MATERIAL UDHËZUES PËR PËRDORIMIN
E LIGJIT NR.119/2014
"PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT"
NË 61 BASHKITË E REJA



BASHKI HAPUR



Qendër nga
INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE



Mëshërues nga
LEVIZ ALBANIA

Ky boom u realizua me mbështetjen e Leviz Albania. Mendimet dhe konceptet e shprehura në të i përket autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Leviz Albania.

Kualiteti i shërbimit nga qytetarët i Shqipërisë: Përkrahja e integritetit dhe transparencës nga programi LKJ Shërbim



Për një qeverisje lokale të mirë dhe demokratike, transparencën përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantojnë për të gjithë qytetarët. Ajo nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Aksesit i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në parandalimin e korrupsionit, dhe si i tillë institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët.



Kodi i Transparencës është një udhëzues që i vjen në ndihmë çdo qytetari duke e orientuar për mënyrën se si të kërkojë informacion mbi dokumentet zyrtare pranë 61 bashkive të vendit. Në këtë manual do të trajtohen udhëzimet që kanë të bëjnë me mënyrat e marrjes së informacionit zyrtar, procedurat e ankimit dhe sanksionet e refuzimit të informacionit, modelet dhe formatet e përdorura për kërkesë dhe ankesë si dhe përgjegjësitë që bashkia ka kundrejt qytetarit sa i takon transparencës dhe informimit. E drejta për informim është e drejta e çdo qytetari për t'u njohur me informacionin publik e garantuar ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr.119/2014 për të drejtën e informimit i cili synon nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Informacioni Publik

Çfarë konsiderohet informacion publik?

Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar nga institucionet publike në çfarëdo lloj forme e formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht se kush ka qenë autoriteti që e ka përgatitur atë.

Kush mund të kërkojë informacion mbi dokumentet zyrtare në bashki?

Çdo qytetar ka të drejtë të ketë akses në informacionet zyrtare pavarësisht nëse i duhet për veten e tij apo për një person të tretë.

A duhet të jepni shpjegim pse ju duhet informacioni?

Mjafton një kërkesë për informacion dhe institucioni i bashkisë nuk ka të drejtë t'ju pyesë për motivin.

A mund të kenë akses në çfarëdo lloji informacioni apo ka ndonjë përjashtim?

Informacionet dhe dokumentet me karakter sekret, konfidencial apo të dhëna nga jeta private e shtetasve, nuk mund të jepen.

Çfarë detyrash i jep ligji për të drejtën e informimit bashkisë?

Bashkia duhet të publikojë Programin e Transparencës në faqen e saj zyrtare dhe në standat pranë mjediseve të saj fizike, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë. Bashkia cakton një nëpunës si koordinatör për të drejtën e informimit, i cili mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe u kthen përgjigje qytetarëve në kohë.

Ky udhëzues ju ndihmon në fillimin e Shërbimit Publik me numërtarjen e programit Lëviz Albania.

Kërkesa për Informacion

Si të bëni një kërkesë për informacion?


VERIFIKO



01

Klikoni **faqen e bashkisë** dhe **verifikoni** nëse informacioni që kërkonti nuk është i shpallur në Programin e Transparencës.

SHKARKO



02

Shkarkoni formatin e kërkesës për informacion në faqen **www.pyetshtetin.al** dhe bëni një kërkesë me shkrim koordinatorit për të drejtën e informimit.

DËRGO



03

Kërkesa dërgohet

- **Dorazi**
(Ruani numrin e protokollit)
- **Nëpërmjet shërbimit postar**
(Ruani kuponin postar)
- **Nëpërmjet e-mailit**
(Ruani emailin e dërguar)
- **Nëpërmjet portalit**
(www.pyetshtetin.al)

PRIT



04

Bashkia ju kthen përgjigje **brenda 10 ditëve pune** nga dorëzimi i kërkesës.

SHTESË




05

Bashkia mund ta **zgjatë afatin** e kthimit të përgjigjes me jo më shumë se **5 ditë**, por duke ju njoftuar paraprakisht.

Refuzimi dhe Ankimimi

Nëse bashkia



Shkarkoni formalin e ankesës në faqen www.pyetshetin.al, bëni një ankesë me shkrim dhe dërgojeni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me:

E-mail: info@idp.al

Dorazi

Postë: Rr. E Kavajës, Nd.80, H1, Tiranë

30

Ankimi tek Komisioneri duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur kërkuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit ose ka kaluar afati për dhënien e tij.

15

Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit të saj.



Çfarë vendos Komisioneri pas vlerësimit të ankesës suaj?



Pronimin e kërkesës dhe urdhërimin e institucionit për të dhënë informacionin e kërkuar ose ndëshkon me gjobë kundër titullarit që ka penguar dhënien e informacionit.



Maspranimin e kërkesës kur nuk është respektuar afati ose forma e paraqitjes.



Rrëzimin e ankesës; pjesërisht ose tërësisht.



Kur Komisioneri nuk merr vendim brenda afatit 15 ditor, ose kur nuk bini dakord me vendimin e tij, ankohuni në gjykatën administrative.

Ky udhëzues është krijuar nga Institut i Bashkëpunimit Publik dhe në bashkëpunim me programin eKöz Albania.

A gjobiten zyrtarët e Bashkisë për refuzimin e informacionit të kërkuar?



Për herë të parë në këtë ligj parashikohen sanksione administrative dhe përgjegjësi individuale ndaj titullarëve të institucioneve (kryetari i bashkisë) dhe nëpunësve të ngarkuar me përgjegjësinë e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në rast të verifikimit nga Komisioneri të shkeljes të së drejtës për informim, aplikohen gjoba të drejtpërdrejta ndaj kryetarit të bashkisë dhe koordinatorit për të drejtën e informimit.

50 mijë deri në 100 mijë lekë

Gjobitet kryetari i bashkisë në rast se:

- Nuk harton dhe nuk publikon Programin institucional të transparencës.
- Nuk rishikon PT brenda afateve të caktuara ligjore (5 vjet).
- Nuk cakton koordinatorin për të drejtën e informimit.

150 mijë deri në 300 mijë lekë

Gjobitet Koordinatorin në rastet kur kërkesa për informacion:

- Refuzohet.
- Nuk plotësohet brenda afatit të caktuar ligjor.
- Nuk dërgohet pranë autoritetit publik që e disponon atë brenda afatit të caktuar ligjor.

Në rastet kur nuk krijon, nuk mban, nuk publikon apo nuk përditëson Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, gjoba ndaj Koordinatorit varion nga **50 mijë deri në 100 mijë lekë**.

Infomohu/Ankohu Tani!

Prite dhe plotëso formularin duke ndjekur udhëzimet.

KERKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/201__ Nënshkrimi: _____
--------------------------------	--	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës: _____	Komente: _____ _____ _____
-----------------------------	--------------------------------	----------------------------------

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përdoren në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". ✓



Pyet Bashkinë



Si i shpenzoi
këtë vit taksat
tuaja?



Si të aplikoni
për bursë
studenti?



Si të aplikoni
për ndihmë
sociale?



Sa leje ndërtimi
ka dhënë bashkia
juaj këtë vit?



Cilat janë
shërbimet
sociale që
ofron
bashkia juaj?



Si mund
ti përfitoni
ato?



Cilat janë
CV-të e admi-
nistratorëve
të bashkisë
suaj?



Si të kërkonti
dëmshpërblim
në rast
fatkeqësish
natyrore?



Sa e kanë
rrogën
zyrtarët e
bashkisë?



Si të
regjistroni
biznesin
tuaj?

**Bashkia nuk mund të vonojë më shumë
se 10 ditë pune përgjigjen e pyetjes suaj!**